

Katër të vdekur
dhe 263 raste të reja
me Covid FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



VAZHDIMI I DIALOGUT DHE KOMPROMISI PËR ASOCIACIONIN, PRESIONE MBI QEVERINË KURTI FAQE 4-5



Bashkimi Evropian (BE) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) vazhdimisht po u bëjnë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i ofrojnë vizionet e tyre se si duhet të duket Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. Përfaqësuesi i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se Uashingtoni ia ka bërë të qartë Qeverisë së Kosovës se për të arritur deri te njohja reciproke me Serbinë duhet të bëjë kompromise. Të njëjtën gjë po kërkojnë edhe përfaqësues të BE-së. Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedime me Serbinë, Edita Tahiri, ka thënë se qeveria Kurti ka ardhur në pushtet duke krijuar kauza të rrejshme kundër formimit të asociacionit dhe tash si qeveri ka obligime ndërkombëtare

OPINION

QËNDRIMI I FAKTORIT
NDËRKOMBËTAR GJATË
VITEVE 1990-1992 F. 5

Prof. dr. Sabit
SYLA



AKTUALE



NË GJERMANI KËRKOHE
HEQJE GRADUALE E MASAVE
KUNDËR PANDEMISË F. 2

MBAHET TRYEZA ME GAZETARË,
ANKOHEN PËR PAGA TË ULËTA DHE
ORARE TË TEJZGJATURA F. 7

EKONOMI



KOSOVA KA DËSHTUAR NË
DIPLOMACINË EKONOMIKE,
KËRKOHE EMËRIMI I ATASHEVE F. 8

TË RINJTË DUHET TË ORIENTOHE
DREJT NEVOJAVE TË TREGUT F. 8

SPORT

DRITA DHE LLAPI SOT LUAJNË
PËR REZULTAT POZITIV F. 10

Haxhiu nënshkruan
deklaratë të përbashkët
zotimi me KGJK-në dhe
Supremen FAQE 2



MBI 5 000 QYTETARË HOQËN DORË
NGA SHTETËSIA VITIN E KALUAR FAQE 4-5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Në Gjermani kërkohet heqja graduale e masave kundër pandemisë

BERLIN, 18 SHKURT - Teksa vala e variantit Omicron të koronavirusit duket se ka prekur pikun në Gjermani, zyrtarët shëndetësorë kanë paralajmëruar të premtën se heqja e kufizimeve duhet të bëhet me kujdes të shtuar. “Të dhënat nga testet e kryera PCR tregojnë se piku i valës së Omicronit ka kaluar”, ka thënë Lars Schaade, zëvendës-president i Institutit për Kontrollin e Sëmundjeve “Robert Koch”. “Megjithatë, piku nuk është arritur në Departamentin për Kujdes

Intensiv”, ka thënë ai, duke shtuar se “vdekjet ditore me koronavirus nuk kanë nisur të bien”. Në 24 orët e fundit janë regjistruar 264 viktima me koronavirus. Një javë më parë shifra ka shkuar në 226. Situata na lejon largim gradual dhe të kujdesshëm të masave për ta kufizuar përhapjen e infektiveve, ka thënë Schaade. Kancelari gjerman Olaf Scholz ka paraqitur të mërkurën planin me tri faza për të larguar pothuajse të gjitha kufizimet

kundër koronavirusit deri më 20 mars.

Ministri gjerman i Shëndetësisë, Karl Lauterbach, vetë mjek, ka bërë paralajmërim të ngjashëm, duke thënë se “ende nuk jemi në ujëra krejtësisht të sigurt”. Ai u ka bërë thirrje liderëve të 16 landeve federale, të cilët kanë pushtet për shumicën e politikave shëndetësore, që të mos veprojnë shumë shpejt. Lauterbach ka thënë se do të ekzistojë një “largim i ngadalshëm” nga kufizimet për luftim të pandemisë.



Stuhia me erë të fuqishme shkakton kaos në Britani të Madhe



LONDËR, 18 SHKURT - Një stuhi goditi Britaninë dhe Irlandën të premtën me erëra rekorde afër 200 kilometra në orë duke ndërprerë energjinë për dhjetëra mijëra njerëz. Stuhia ka detyruar aeroplanët t'i shmangin uljet, ka shkukur drunjtë dhe shkatërruar çatitë në të gjithë vendin. Stuhia goditi Anglinë perëndimore, duke zbritur në Cornwall, ku dallgët goditën bregun, duke dërguar spërkatjeje mbi çatitë e vilave, treguan fotot e “Reuters”-it. Në Uells dallgët u përplasën

mbi shëtitoren Aberystwyth, disa të larta sa një shtëpi. Më shumë se 100 000 njerëz u goditën nga ndërprerjet e energjisë elektrike, ndërsa linjat u shkatërruan dhe drunjtë e lashtë u shkullën. “Stuhia Eunice është me të vërtetë një goditje. Ne lëshojmë alarm të kuq të motit vetëm kur mendojmë se ka një kërcënim për jetën nga moti”, ka thënë meteorologu Frank Saunders. Zyra e Meteorologjisë ka njoftuar se era e fuqishme (196 km në orë) u regjistrua si një rekord për stuhinë më të

fuqishme të regjistruar ndonjëherë në Angli. Avionët u goditën aq fort nga rrymat e ajrit në disa aeroporte sa pilotët u detyruan t'i shmangnin uljet. Linjat ajrore anuluan dhjetëra fluturime, ndërsa disa fluturime kërkuan ulje më të sigurta në aeroporte të tjera. Alarme të tilla të motit të keq në Britani janë relativisht të rralla. I fundit i lëshuar ishte në nëntor 2021. Qeveria britanike do të mbajë një takim të reagimit emergjent për të diskutuar përgjigjen ndaj stuhisë.

Holanda do të dërgojë pajisje ushtarake në Ukrainë

AMSTERDAM, 18 SHKURT - Holanda planifikon të dërgojë pajisje ushtarake në Ukrainë, duke përfshirë pushkë, municione, sisteme radari dhe robotë për zbulimin e minave, ka njoftuar qeveria të premtën. “Ne vazhdojmë të synojmë për një zgjidhje diplomatike”, ka pohuar ministri i Jashtëm, Wopke Hoekstra. “Por, në të njëjtën kohë, Ukraina duhet të jetë në gjendje të mbrohet kundër një sulmi të mundshëm rus”, ka

thënë ai. Ministria ruse e Mbrojtjes ka njoftuar se të shtunën, më 19 shkurt, do të mbahen stërvitje të reja ushtarake, të cilat do të mbikëqyren nga presidenti rus Vladimir Putin, në kohën e shqetësimeve se Kremli mund të jetë duke u përgatitur për pushtim të Ukrainës. Në stërvitje është thënë se do të marrin pjesë trupa dhe pajisje të forcave të hapësirës ajrore nga rajoni jugor, ai verior dhe Deti i Zi.

Inteligjenca amerikane vlerëson se rreth 130 000 trupa dhe pajisje ushtarake gjenden në zonat në kufi me Ukrainën. Kremli këmbëngul se NATO nuk duhet ta pranojë kurrë Ukrainën dhe duhet t'i tërheqë forcat e saj pranë kufijve të Rusisë, por Perëndimi ka refuzuar atë që e quan ofertë nga Moskë për të diktuar të ardhmen e partnerëve të pavarur dhe e kërcënoi Moskën me “kosto të rënda” nëse sulmon Ukrainën.



ShBA-ja dërgon 5 milionë vaksina kundër Covidit në Egjipt dhe Nigeri



UASHINGTON, 18 SHKURT - Shtetet e Bashkuara dërguan të enjten në Egjipt dhe Nigeri rreth 5.2 milionë doza të vaksinës kundër Covid-19, të kompanisë “Pfizer”, ka njoftuar një zyrtar i Shtetësisë së Bardhë për AFP.

Dërgesat janë pjesë e një fushate globale donacionesh nga Shtetet e Bashkuara. Më shumë se 400 milionë doza janë dërguar tashmë,

prej 1.1 miliard sa ishte objektivi. Zyrtari i Shtetësisë së Bardhë tha se rreth 3 milionë doza të vaksinës “Pfizer” janë dërguar në Nigeri dhe mbi 2 milionë doza të tjera në Egjipt.

Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera që prodhojnë vaksina kundër sëmundjes Covid-19 janë kritikuar se nuk kanë bërë sa duhet për ta zbutur përhapjen e virusit.

Haxhiu nënshkruan deklaratë të përbashkët zotimi me KGJK-në dhe Supreme

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë është nënshkruar një deklaratë e përbashkët zotimi në mes të ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj, si dhe kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës,

Enver Peci. Përmes kësaj deklaratë Ministria e Drejtësisë zotohet se në afatin më optimal do t'i formojë grupet punuese për kryerjen e hapave procedurale dhe nxjerrjen e dokumenteve përkatëse për reformat. "Në anën tjetër, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjykata

Supreme, me nënshkrimin e kësaj Deklarate, zotohen të kontribuojnë substancialisht në këtë proces, duke dhënë kontribut të vazhdueshëm profesional përmes përfaqësuesve kompetentë. Ky akt shënon një zotim të plotvullnetshëm për ta ngritur

nivelin e bashkëpunimit dhe kontributit në mes të këtyre institucioneve, me qëllimin e qartë për reforma në fushat e caktuara të sundimit të ligjit, ndër të tjera, në atë penale, civile dhe administrative. Zotimi i tillë, gjithashtu, është i rëndësishëm për bashkëpunimin dhe

kontributin profesional të partnerëve strategjikë si pjesë e rëndësishme e reformave në drejtësi", ka njoftuar MD-ja, duke shtuar se një akt i tillë shënon përkushtimin dhe bashkëpunimin e institucioneve të drejtësisë për të kontribuar në proceset reformuese në drejtësi.



Mbi 5 000 qytetarë hoqën dorë nga shtetësia vitin e kaluar

Prishtinë, 18 shkurt - Mbi 5 000 qytetarë të Kosovës kanë hequr dorë nga shtetësia vitin e kaluar për shkak se në shumicën e shteteve evropiane nuk lejohet dyshtetësia, ndërsa rreth 570 persona kanë kërkuar azil në Kosovë, ndryshe nga viti 2020 që ishin rreth 1 500 persona që kanë kërkuar azil në vendin tonë.

Drejtori i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion, Liridon Neziri, ka deklaruar për "KosovaPress" se numri më i madh i personave që kanë hequr dorë nga shtetësia e



Kosovës janë nga Gjermania dhe se, sipas tij, vetëm Franca dhe Zvicra nuk obligojnë lirin

nga shtetësia e Kosovës. "Për vitin 2021 kemi mbi 5 mijë persona që kanë hequr dorë nga

shtetësia e Republikës së Kosovës. Arsyja e heqjes dorë nga shtetësia është pasi që disa vende nga Bashkimi Evropian nuk lejojnë dy nënshtetësi për shtetasit që nuk janë pjesë e Bashkimit Evropian duke pasur parasysh që ne kemi një numër të madh të emigracionit, pra shtetasit tanë të cilët kanë emigruar me vite", ka thënë Neziri.

Në Kosovë ka edhe persona që kërkojnë azil. Sipas Nezirit, numri i azilkërkuësve është më i vogël në vitin 2021 se në vitin 2020. "Në krahasim me vitin

2020, në vitin 2021 jemi përballur me numër më të vogël sa iu përket azilkërkuësve. Sigurisht që viti 2020 ka qenë si pasojë e pandemisë dhe mungesës së lëvizjeve që ua kanë pamundësuar emigrantëve të lëvizin, pasi dihet se Kosova nuk është një vend destinacioni sa iu përket azilkërkuësve", ka thënë ai.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2021 në Divizionin e Shtetësisë janë marrë 5 031 vendime për lirim nga shtetësia: 4 940 vendime pozitive, 91 vendime negative.


Osmani, Kurti dhe Gërvalla marrin pjesë në Konferencën e Sigurisë në Mynih

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti kanë udhëtuar për në Gjermani, ku do të marrin pjesë në Konferencën e Sigurisë në Mynih (MSC). Në margjinat të MSC-së, presidentja Osmani do të zhvillojë një sërë takimesh dypalëshe me liderë të tjerë botërorë, si dhe me krerë të organizatave ndërkombëtare.

"Presidentja Osmani do të marrë pjesë edhe në panele diskutimi për çështjet e lidhura me sigurinë, duke përfshirë zhvillimet në Ballkanin Perëndimor dhe sfidat e paraqitura për kombet demokratike në mbarë botën", ka njoftuar Presidenca.

Edhe qeveria ka njoftuar se Kurti, i shoqëruar edhe nga zëvendëskryeministria,

njëherësh ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, do të qëndrojnë atje për tri ditë gjatë të cilave do të zhvillojë takime të ndryshme bilaterale. MSC është themeluar më 1963 dhe që nga atëherë është një forum i pavarur në të cilin promovohen zgjidhjet paqësore të konflikteve, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe dialogu.





Vazhdimi i dialogut dhe kompromisi për asociacionin, presione mbi qeverinë Kurti

Bashkimi Evropian (BE) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) vazhdimisht po u bëjnë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i ofrojnë vizionet e tyre se si duhet të duket Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. Përfaqësuesi i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se Uashingtoni ia ka bërë të qartë Qeverisë së Kosovës se për të arritur deri te njohja reciproke me Serbinë duhet të bëjë kompromise. Të njëjtën gjë po e kërkojnë edhe përfaqësuesit e BE-së. Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedime me Serbinë, Edita Tahiri, ka thënë se qeveria Kurti ka ardhur në pushtet duke krijuar kauza të rrejshme kundër formimit të asociacionit dhe tash si qeveri ka obligime ndërkombëtare

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 18 SHKURT - Përfaqësuesi i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, gjatë vizitës që patën në Kosovë në fillim të këtij muaji, kanë kërkuar prej Kosovës zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në Bruksel.

Gabriel Escobar ka thënë se nuk kanë ardhur këtu me recetë propozimesh që do të dëshironin imponim por, sipas tij, Kosova dhe Serbia duhet t'i ofrojnë vizionet e tyre se si duhet të duket Asociacioni. "Në fakt, ne po kërkojmë nga të dyja palët [Kosova dhe Serbia] që të jenë konstruktive, t'i

ofrojnë vizionet e tyre se si duhet të duket Asociacioni, pastaj të negociojnë prej aty në kuadër të dialogut", ka thënë Escobar.

Këtë të mërkurë që lamë pas, para Nënkomitetit për Punë të Jashtme të Senatit amerikan, Escobari ka thënë se Uashingtoni ia ka bërë të qartë Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, se për të arritur deri te njohja reciproke me Serbinë duhet të bëjë kompromise.

Duke folur për dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, që synim ka normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve dhe ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, Escobari tha se ky proces nuk është për statusin e Kosovës, por për njohjen e ndërsjellë me Serbinë. "Ne kemi qenë shumë të qartë me Qeverinë e Kosovës,

se ne presim që ata të angazhohen plotësisht në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja dhe t'i shohin bisedimet si negociata të vërteta për ta arritur qëllimin kryesor të tyre - që është njohja e ndërsjellë me Serbinë, njohja nga pesë shtetet e BE-së dhe anëtarësimi në të gjitha organizatat ndërkombëtare ku duan të anëtarësohen.

Kjo do të kërkojë kompromis dhe ne kemi qenë shumë të qartë. Ambasadori ynë i ri [në Kosovë], Jeffery Hovenier, e ka bërë këtë shumë të qartë gjatë takimeve të tij të para me qeverinë Kurti dhe ai do të vazhdojë ta bëjë këtë e ne do të vazhdojmë ta mbështesim atë", ka deklaruar Escobar.

Ai ka bërë me dije se modelet e asociacionit nuk duhet ta dëmtojnë sovranitetin e Republikës së Kosovës. "Nuk

duhet të jenë ato modele që minojnë sovranitetin apo funksionalitetin e Kosovës. Pra, ne duhet të gjejmë një. Ato mund të gjenden, mund të negociohen dhe mund të dakordohen. Ky është qëllimi i dialogut. Nuk është qëllimi i ShBA-së të imponojë një [model] ose të zgjedhë një, në emër të palëve", ka thënë Escobar.

Edhe i dërguar i BE-së për këtë proces, Miroslav Lajçak, ka thënë se askush nuk dëshiron Republikë Sërpska në Kosovë. "Nëse duam t'i japim fund ekzistencës së strukturave paralele [serbe në Kosovë], nëse duam transparencë në rrjedhat financiare, nëse duam rregulla të qarta në veri, këto mund të bëhen të gjitha brenda sistemit kushtetues dhe juridik të Kosovës", është shprehur Lajçak.

Ai u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës që të mos frikësohen nga procesi i dialogut. "Këshilla ime: Mos kini frikë nga diçka që nuk ekziston dhe askush nuk do t'ju imponojë. Jini të sigurt në vetvete, të vetëdijshëm për faktin se ju jeni bashkudhëheqës në këtë proces dhe jeni partnerë të barabartë. Nuk ka absolutisht asnjë arsye

për t'u frikësuar nga procesi që po zhvillohet me Serbinë dhe ne jemi këtu për të siguruar se çdo vendim që do të merret, do të bazohet në standardet dhe vlerat e normave evropiane", ka deklaruar Lajçaku.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka mohuar se serbët e Kosovës duan formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ai ka thënë se asociacioni është kërkesë e Serbisë, që ka për qëllim të shkaktojë tensione në Kosovë. Sipas tij, serbët e Kosovës duan drejtësi dhe punësim. "Unë besoj se edhe serbët, porsiqiptarët, turqit, boshnjakët, egjiptianët, ashkalinjtë, të gjithë qytetarët e Republikës kanë nevojë për drejtësi dhe punësim e jo për asociacione të cilat na shtojnë tensionet, na i prishin raportet tona dhe e gëzojnë dikë në Beograd. Nuk ka qenë asnjëherë kërkesë e serbëve të Kosovës. Serbët e Kosovës duan drejtësi dhe punësim. Andaj, duhet t'i dallojmë kërkesat që vijnë prej poshtë dhe kanë karakter demokratik e shoqëror, prej kërkesave që vijnë prej lart dhe kanë karakter jodemokratik e hegjeonik. Pra, Qeveria e Kosovës është e përkushtuar që kushtetutshmëria e ligjshmëria

në gjithë territorin e Kosovës të respektohet e të zbatohet në mënyrë të plotë. Për të gjitha kërkesat e serbëve të Kosovës unë jam kryeministër edhe i tyre”, ka deklaruar këto ditë Kurti.

Ai ka theksuar se Kosova dëshiron dialog për marrëveshje e jo dialog për dialog.

Për marrëveshjen e asociacionit që është arritur në Bruksel, ai ka thënë se ajo ka rënë në testin e Gjykatës Kushtetuese. “Ju e dini shumë mirë që Gjykata Kushtetuese më 2015 ka publikuar Aktgjykimin e vet me të cilin ka thënë se asnjëri prej shtatë kapitujve të asociacionit nuk është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, rrjedhimisht ai asociacion nuk e ka kaluar testin e Gjykatës Kushtetuese”, ka thënë Kurti.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në deklarimet e saj për medie ka theksuar se institucionet e Kosovës nuk kanë pranuar propozime për autonomi të zgjeruar në pjesën veriore të Kosovës apo Asociacion me kompetenca ekzekutive. “Propozimet për të cilat po përflitet për, kinse, autonomi të zgjeruar apo ndonjë lloj Asociacioni me kompetenca ekzekutive, asnjëherë nuk u janë prezantuar institucioneve të Republikës së Kosovës. Kanë qenë përfaqësuesit e Republikës së Kosovës ata të cilët kanë nënshkruar marrëveshje të dëmshme, të cilat Asociacionit i kanë dhënë kompetenca ekzekutive. Duhet ta themi realitetin, pasi e zëza është mbi të bardhën. Është letër e nënshkruar nga ish-kryeministria të Kosovës dhe përgjegjësia duhet të merret si e

tillë”, ka thënë Osmani. Ajo ka thënë se institucionet e Kosovës janë të vendosura që të mos lejojnë zbatimin e modeleve që do ta bënin këtë shtet jofunksional.

Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedime me Serbinë, Edita Tahiri, ka bërë me dije se ka ardhur koha që Kosova ta ketë një qëndrim më të qartë në raport me dialogun me Serbinë. Ajo ka thënë se ky qëndrim nënkupton ndaljen e dialogut teknik dhe fillimin e diskutimit për marrëveshjen finale. Tahiri ka thënë se nëse kryeministri Albin Kurti do të angazhohet për zbatimin e marrëveshjes së asociacionit, ai do ta tradhtonte elektoratin e vet. Sipas saj, Kurti ka ardhur në pushtet duke krijuar kauza të rrejshme kundër formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. “Qeveria Kurti ka ardhur në pushtet duke krijuar kauza të rrejshme kundër formimit të asociacionit dhe kundër demarkacionit me Malin e Zi. Së pari, nëse kjo qeveri dhe Albin Kurti e zbatojnë marrëveshjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. “Qeveria Kurti ka ardhur në pushtet duke krijuar kauza të rrejshme kundër formimit të asociacionit dhe kundër demarkacionit me Malin e Zi. Së dyti, natyrisht se kjo qeveri ka obligime ndërkombëtare. Ne kemi parë se kjo qeveri arriti ta anuloi marrëveshjen e Uashingtonit në Kuvend, pastaj e anuloi projektin për gazsjellësin amerikan. Këto veprime lënë shumë dyshime për orientimin e kësaj qeverie. Tani kjo qeveri nuk bashkëpunon në raport me asociacionin. Unë nuk i jap këshilla kësaj qeverie, por mendoj se në raport me aleatët perëndimorë kjo qeveri duhet të mendojë thellë. Kosova si shtet është i suksesshëm vetëm

Kur u arrit marrëveshja për Asociacionin?

Në prill të vitit 2013 Kosova dhe Serbia, në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga Brukseli, patën arritur Marrëveshjen e parë të Brukselit. Në bazë të asaj marrëveshjeje parashihej edhe krijimi i një Asociacioni/Bashkësie të Komunave me Shumicë Serbe. Sipas marrëveshjes, Asociacioni do të krijohet me statut dhe do të themelohej mbi po të njëjtat baza sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të Komunave të Kosovës si, për shembull, do të ketë kryetar, zëvendëskryetar, asambleje dhe këshill.

Asociacioni do të ketë qasje të plotë në fushat e zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural dhe do të ushtrojë edhe përgjegjësi të tjera shtesë, varësisht se si delegohen nga autoritetet qendrore.

Më 2015, po në kuadër të dialogut të Brukselit, palët arritën marrëveshje mbi parimet për krijimin e këtij

asociacioni, marrëveshje e cila ende nuk është jetësuar, përkundër insistimit të Beogradit zyrtar. Sipas Marrëveshjes për Asociacionin dhe në përputhje me marrëveshjen e parë të Brukselit, objektivat kryesore të Asociacionit janë: ushtron vështrimin e plotë për zhvillimin e ekonomisë lokale; ushtron vështrimin e plotë në fushën e arsimit; ushtron vështrimin e plotë për përmirësimin e shëndetësisë lokale primare e sekondare dhe përkujdesjen sociale; ushtron vështrimin e plotë për koordinimin e planifikimit urban dhe rural; aprovon masa për përmirësimin e kushteve lokale të jetesës për të kthyerit në Kosovë; zhvillon, koordinon, lehtëson aktivitete hulumtuese dhe zhvillimore; promovon, shpërndan, dhe avokon për çështjet me interes të përbashkët të anëtarëve të tij dhe i përfaqëson ata përfshirë tek autoritetet qendrore; vendos marrëdhënie dhe hyn

në marrëveshje bashkëpunimi me asociacionet e tjera të komunave, vendore dhe ndërkombëtare etj.


Në tetor të vitit 2015 kjo marrëveshje ishte dërgua për interpretim në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nga presidentja e atëhershme e Kosovës, Atifete Jahjaga. Gjykata Kushtetuese, në vendimin e nxjerrë në dhjetor të vitit 2015, pati njoftuar se Marrëveshja për Asociacionin në 23 pika të saj nuk është në harmoni me Kushtetutën e Kosovës. Gjykata kishte konstatuar që Asociacioni e Komunave me Shumicë Serbe do të themelohej siç ishte paraparë me Marrëveshjen e parë të Brukselit (të vitit 2013), të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës dhe të shpallur nga presidentja e Republikës së Kosovës (v.j. Atifete Jahjaga), kurse marrëveshja mbi parimet (për themelimin e Asociacionit, e arritur më 2015), nuk është tërësisht në përputhje me frymën e Kushtetutës.

kur ka politika të brendshme funksionale dhe politika të jashtme funksionale, të cilat forcojnë marrëdhëniet me aleatët strategjikë. Këtu kam parasysh ShBA-në, Gjermaninë, BE-në, NATO-n etj”, ka thënë Edita Tahiri.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, me rastin e 14-vjetorit të

pavarësisë së Kosovës, e ka urren presidenten Vjosa Osmani me rastin e 17 Shkurtit, duke theksuar se Shtetet e Bashkuara mbesin partner i palëkundur i Kosovës. Bideni në këtë letër ka shkruar edhe për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. “Jemi të kënaqur që Kosova po vazhdon t’i ndërtojë dhe forcojë marrëdhëniet e saj

pozitive me vendet fqinje dhe do të vazhdojmë t’i mbështesim përpjekjet tuaja drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse të normalizimit me Serbinë, të përqendruar në njohjen reciproke”, ka shkruar Biden. Në vitin 2013 dy vendet kanë arritur marrëveshje për themelimin e këtij asociacioni, por zbatimin e saj ka ngecur.



QËNDRIMI I FAKTORIT NDËRKOMBËTAR NDAJ KËRKESAVE TË SHQIPTARËVE
TË KOSOVËS PËR PAVARËSI 1990-1999 (2)

Qëndrimi i faktorit ndërkombëtar gjatë viteve 1990-1992



Prof. dr. Sabit SYLA

Angazhimi për zgjidhjen e drejtë të statusit të Kosovës në formë të pavarësisë së saj u prit ftohtë jo vetëm nga faktori ndërkombëtar, por edhe nga njësitë tjera federale. Vetëm Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përmes një Deklarate, më 21 tetor 1991, njohu Republikën e Kosovës, si shtet sovran e të pavarur, mbi bazën e lirisë dhe barazisë të plotë me të gjithë popujt tjerë. Shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte bërë në rrethana të ndërlikuara ndërkombëtare e aspak të përshtatshme për shqiptarët e Kosovës. Shpërbërja e Jugosllavisë, si një shtet i larmishëm në aspektin etnik, religjioz e kulturor dhe me një pozitë strategjike gjeopolitike paraqiti një sfidë tepër specifike për komunitetin ndërkombëtar, sidomos për BE-në dhe ShBA-në, pasi ky proces u zhvillua mu në kohën e përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe krijimit të një sistemi të ri ndërkombëtar.

Qëndrimi i faktorit ndërkombëtar ishte një gërshetim i rrethanave të ndërlikuara politike ndërkombëtare. Përfundimi i Luftës së Ftohtë dhe fillimi i krijimit të një rendi të ri ndërkombëtar, të shoqëruar edhe nga shpërbërja e Jugosllavisë, Çekoslovakisë dhe Bashkimit Sovjetik, paraqitën një sfidë tepër të rëndë për ShBA-në dhe Evropën. Sfidat kryesore qëndronte në përcaktimin e prioritetëve kryesore në politikën e jashtme dhe qasja që duhej marr ndaj zhvillimeve të reja. Bashkimi i Gjermanisë kishte rrezikuar pozitën dominuese të Britanisë së Madhe e të Francës në Evropë. Për t'u promovuar si një faktor me rëndësi në skenën politike evropiane Gjermania mbështeti shkëputjen e Sllovenisë dhe të Kroacisë nga Jugosllavia, ndërsa Franca e Britania nuk favorizonin krijimin e shteteve të reja. Ndryshe nga Evropa, për ShBA-në Jugosllavia nuk paraqiste më tej ndonjë rëndësi strategjike sikurse në të kaluarën, kur kishte luajtur rolin e balancuesit midis Lindjes e Perëndimit, prandaj shpërbërja e saj nuk paraqiste ndonjë rëndësi për të. Por, presidenca e ShBA-së ishte në dijeni të një raportit të përpiluar në nëntor 1990 nga

CIA, që parashihte trazira e dhunë etnike, prandaj për të evituar zhvillime të tilla diplomacia amerikane u angazhua për "demokraci, dialog, të drejta të njeriut, ekonomi tregu dhe unitetin".

Komuniteti ndërkombëtar, i preokupuar nga rrethanat e mësipërme, që u acaruan edhe më tepër me nisjen e konfliktit të armatosur në Kroaci e Bosnjë-Hercegovinë, nuk e pa të udhës t'i kushtonte vëmendje kërkesave që vinin nga shqiptarët e Kosovës. Ai u mjaftua vetëm në angazhimin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe rikthimin e një autonomie lokale në Kosovë. Një qëndrim i tillë dëshmohej nga rezoluta e Parlamentit Evropian, e miratuar më 15 shkurt 1990, për gjendjen në Kosovë dhe respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe nga Rezoluta e Përbashkëta Senatit dhe Kongresit Amerikan e cila në esencë bënte thirrje për ndalimin e dhunës, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe rikthimin e autonomisë politike të Kosovës.

Prireja e faktorit ndërkombëtar për mosnjohjen e kërkesës së Kosovës për pavarësi u përforcua edhe me tepër për shkak se komuniteti ndërkombëtar i mungonte kompetenca për të analizuar pasojat ligjore e ekonomike që dilnin nga shpërbërja e Jugosllavisë. Prandaj, Bashkimi Evropian formoi në gusht të vitit 1991 Komisionin e Badinterit, si një mekanizëm që do t'i ofronte Konferencës së Paqes këshilla ligjore lidhur me Jugosllavinë. Komisioni kishte për detyrë të lehtësonte dallimet që mund të paraqiteshin në bisedimet

paqësore midis subjekteve jugosllave që së shpejti do të fillonin në Hagë, por po ashtu lëshoi edhe një numër opinionesh juridike lidhur me statusin e Jugosllavisë e të njësisë të saja konstitutive. Ndonëse nuk kishin karakter obligues, këto opinione kishin rëndësi specifike dhe u reflektuan në rastin e Kosovës, sidomos ato që kishin të bënin me të drejtën e vetëvendosjes së popujve dhe me kufijtë në momentin e pavarësimin. Opinioni nr. 2 nuk njihte të drejtën e vetëvendosjes së një populli brenda një republike dhe shprehej në favor të garantimit të të drejtave etnike dhe minoritare, ndërsa opinioni nr. 3, përkujtonte se kufijtë midis republikave nuk mund të ndryshoheshin.

Opinionet e Badinterit e vështirësuan edhe më tej pozitën e Kosovës në arenën ndërkombëtare, sepse ajo nuk kishte qenë një republikë në ish federatën jugosllave, por vetëm një krahinë me në autonomi të caktuar politike e cila tanimë ishte revokuar dhunshëm nga Serbia. Duke marr për bazë opinionet e Badinterit, komuniteti ndërkombëtar u angazhua vetëm në ruajtjen e paqes dhe qetësisë në Kosovë, të cilën synonte ta arrinte përmes realizimit të së drejtave etnike apo minoritare. Mbi këtë bazë u hartuan propozime të ndryshme të cilat u shtjelluan në Konferencën e Hagës gjatë vitit 1991, sikurse "statusi special" apo një lloj autonomie e zgjeruar për banorët e minoritetit që formonin shumicën në hapësirën ku ata jetonin. Këto minoritete duhej të gëzonin të drejtat si: sistem arsimor i veçantë, organe të veçanta

legjislative, strukturë administrative e gjyqësore etj.

Qëndrimi i tillë i komunitetit ndërkombëtar ishte po ashtu një refleksion ndaj kërkesave që paraqisnin serbët në Kroaci apo Bosnjë-Hercegovinë. Angazhimi për ruajtjen e integritetit territorial të këtyre dy republikave u reflektua edhe në rastin e Serbisë. Komuniteti ndërkombëtar po ashtu veprroi në drejtim të ruajtjes së integritetit territorial të Serbisë, duke e njohur Kosovën si pjesë përbërëse të saj. Njohja e juridiksionit të Serbisë mbi Kosovën mund të bazohet në deklaratat e disa diplomatëve evropianë. Lordi Owen, përfaqësues i kësaj Konferencë, në fjalimin për shtyp të mbajtur në Prishtinë ku iu drejtua shqiptarëve e serbëve: "Serbët duhet të pajtohen me autonominë e Kosovës, kurse shqiptarët - vazhdonte ai - duhet ta pranojnë Serbinë". Edhe zëvendësi i ministrit të Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, Daglas Hog, me rastin e hapjes së Ambasadës britanike në Shkup, në dhjetor 1993, ndër të tjera deklaroi: "Ajo (Kosova) është pjesë e shtetit tashmë të Serbisë. Nuk synojmë ta shkatërrojmë integritetin e Serbisë, problemi do të zgjidhet brenda saj, Serbia do të jetë e detyruar që Kosovës t'i japë të drejtat politike më të gjera deri në autonomi". Pro një autonomie të gjerë për Kosovën u shprehën edhe Italia, Gjermania e Franca. Po ashtu, edhe administrata e Bill Klintonit paraqiste për Kosovën një autonomi të gjerë nën sovranitetin e Serbisë.

Pra, komuniteti ndërkombëtar, u tregua i njëanshëm dhe si rrjedhojë insistonte në ruajtjen e

paqes por edhe të integritetit të Serbisë. Për të arritur këtë objektiv komuniteti ndërkombëtar veprroi në dy mënyra: së pari, paralajmëroi Serbinë të hiqte dorë nga dhuna - më 24 dhjetor 1992, presidenti Bush i dërgoi një letër Sllobodan Millosheviqit, që u bë e njohur si "Paralajmërimi i Kërshëndellave", që theksonte se: "Në rast konflikti në Kosovë të shkaktuar nga veprimet serbe, ShBA-ja do të përgatitet ta përdorë forcën ushtarake kundër serbëve në Kosovë e në Serbi". Së dyti, tentoi t'i bindte liderët e shqiptarëve të Kosovës të ri-integroreshin në sistemin politik të Serbisë, me shpresën se do të ndikonin në ndryshimin e pushtetit e me këtë edhe të fitimit të të drejtave të tyre. Në vazhdim të këtij synimi, lideri opozitar serb Milan Paniq, ishte takuar në Londër me Ibrahim Rugovën dhe i kishte ofruar këtij të fundit rivendosjen e të drejtave të njeriut dhe të një autonomie për Kosovën nëse shqiptarët do të dilnin në zgjedhje. Por, shqiptarët e Kosovës nuk kishin marr pjesë në zgjedhjet serbe pasi që konsideronin se Republika e Kosovës nuk është pjesë përbërëse e Jugosllavisë. Në kujtimet e tij, ambasadori amerikan në Beograd vinte në pah këmbënguljen e udhëheqjes së shqiptarëve të Kosovës për të mos njohur autoritetin e Serbisë. Qëndrimi i tillë i udhëheqjes kosovare i bëri të ditur komunitetit ndërkombëtar se shqiptarët ishin të vendosur në rrugën drejt lirisë e pavarësisë dhe se nuk do të kishte kthim prapa në aspiratat kombëtare. Ky qëndrim vendosi bazën e kërkesës për pavarësi që do të parashtrohet në rrethana krejt tjera disa vite më pas. (Vijon)



Katër të vdekur dhe 263 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur katër persona të infektuar me Covid-

19. Po kjo ministri ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë raportuar 236 raste të reja me Covid-19 dhe janë shëruar 780 persona. "Nga 2 648

testime, 236 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 4 raste të vdekjes. Sot janë shëruar 780

qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 215 665. Në total numri i rasteve aktive është 5 961", ka njoftuar MSh-ja.



Mbahet tryeza me gazetarët, ankohen për paga të ulëta dhe orare të tejzgjatura

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 SHKURT - Drejtori ekzekutiv në Këshillin e Medieve të Shkruara të Kosovës, Imer Mushkolaj, ka thënë se në vendin tonë mungon edukimi medial. "Ne si shoqëri, si komunitet gazetarësh, nuk vuajmë nga mungesa e kodeve, por nga mosrespektimi i këtyre kodeve. Kodi është diçka e thjeshtë me parimet bazë të punës së gazetarit por, fatkeqësisht, në mediet tona gjërat që publikohen nuk përmbushin as rregullat bazë", ka thënë Mushkolaj në tryezën e organizuar rreth diskutimit "Pozita e gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës tani përballë ndryshimeve teknologjike". Mushkolaj ka folur edhe për mungesën e edukimit medial dhe atë se sa e vështirë është sot për njerëzit të dinë se çfarë përmbajtje të lexojnë çdo ditë online, cila është etike, apo të kalojnë në tri apo katër medie të ndryshme vetëm për ta marrë informacionin e duhur.

Gjatë këtij paneli u diskutua edhe për pozitën e gazetarëve me zhvillimet teknologjike në vitet e fundit, për numrin e madh të medieve sot, po ashtu edhe vëllimin e madh të informacioneve që postohen, për



lajme që (s)përkojnë me rregullat etike dhe si qëndrojmë në këtë aspekt.

Xhemajl Rexha, kryetar i bordit në AGK, ka folur për autocensurën në medie dhe se si redaktorët dhe

kryeredaktorët janë përgjegjës për atë që publikohet në mediet e tyre, si trajtohen praktikantët dhe gazetarët e rinj në redaksi dhe për mungesën e kujdesit dhe mentorimit ndaj tyre. Ai ka

treguar që janë duke u planifikuar që gazetarët të marrin ndihmë juridike falas.

Gentiana Begolli, redaktore në RTK, ka folur më shumë rreth pozitës së gazetarëve sot, për

problemet që kanë me pagat e ulëta, për oraret e tejzgjatura të punës, për diskriminimet gjinore, për diskriminimet në paga, për kushtet e punës dhe për rritjen e madhe të numrit të medieve.

Kërkohet paraburgim kundër gjashtë të arrestuarve për rastin e kultivimit të narkotikëve



PRIZREN, 18 SHKURT (ER) - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka kërkuar caktimin e masës së paraburgimit nga Gjykata Themelore në Prizren ndaj të pandehurve A. R., M. V., E. M., F. M., A. M. dhe E. D., të cilët me vendim të Prokurorit të Shtetit gjenden nën masën e ndalimit 48 orë nga data 16.02.2022. Sipas kërkesës së prokurorisë, nga data e pavërtetuar e deri me datë

16.02.2022, pa autorizim, kanë kultivuar bimën e hashashit, shkurren së kokainës ose bimën e kanabisit, me qëllim të prodhimit të narkotikeve ose substancave psicotropike. "Në bashkëryerje me njëri-tjetrin kanë kultivuar bimën narkotike brenda një objekti që ka shërbyer si mull në fshatin Shirokë, komuna e Suharekës, në katin e 7-të, ashtu që me datë 16.02.2022, rreth orës 14:15 minuta, me rastin e ekzekutimit të urdhër kontrollit,

në objektin e cekur është zbuluar vendi ku bëhej kultivimi i bimës narkotike, pajisjet dhe materialet për kultivimin e bimës narkotike si dhe rreth 32 kilogramë, substancë të dyshuar narkotike të llojit marijuanë, e cila ishte në procesin e tharjes, si dhe 2059 saksi - vazo, që kishin të mbjella bimë të dyshuara të llojit kanabis sativa, po ashtu në vendin e ngjarjes janë zënë në flagrancë të gjithë të pandehurit", ka njoftuar Prokuroria Themelore në Prizren.

Rifunksionalizohet aplikacioni që tregon kohën për qarkullimin e autobusëve në Prishtinë

Prishtinë, 18 shkurt (ER) - Trafiku Urban në Prishtinë ka bërë me dije se është rikthyer në funksion mobil dhe tani mund ta

monitoroni në kohë reale qarkullimin e autobusëve në linjat e TU-së. Në njoftimin për medie është bërë me dije se në kohë reale mund të

shikohet qarkullimi i autobusëve në linjat e trafikut urban. "Ju njoftojmë se është rikthyer në funksion aplikacioni mobil dhe tani

mund të monitoroni në kohë reale qarkullimin e autobusëve në linjat e TU-së", ka njoftuar Trafiku Urban në Prishtinë.



Kosova ka dështuar në diplomacinë ekonomike, kërkohet emërimi i atasheve

PRISHTINË, 18 SHKURT - Kosova ka bërë dje 14 vjet shtet dhe ende është pa diplomaci ekonomike të qëndrueshme dhe pa atashe ekonomike në misionet diplomatike. Që nga shpallja e pavarësisë vendi ka ngecur në promovimin e prodhimit vendor, si dhe kapacitetin turistik të saj para botës.

Komuniteti i biznesit vlerëson se Kosova ka dështuar në diplomacinë ekonomike, përkatësisht në emërimin e atasheve ekonomike, të cilët do të lobonin për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, për tërheqjen e investimeve të huaja, si dhe për krijimin e marrëdhënieve ekonomike me shtetet e zhvilluara.

Në anën tjetër në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe asaj të Tregtisë kanë zgjedhur heshtjen për këtë çështje. Përkundër insistimit, nuk janë përgjigjur për "KosovaPress".

Drejtori ekzekutiv në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka vlerësuar se diplomacia ekonomike duhet të jetë prioritet i kësaj qeverie ani se, sipas tij, për 13 vjet qeveritë e kaluara kanë dështuar në këtë aspekt.

Zeka ka thënë për "KosovaPress" se angazhimi në diplomacinë ekonomike do ta fuqizonte edhe subjektivitetin e Kosovës për njohje të reja. "Qeveria gati mbush edhe njëvjetorin e plotë të

saj, dhe arsyeja pse bëra një krahasim të tillë ose një referencë të tillë kohore është për të treguar se në 13 vitet e kaluara qeveritë e ndryshme janë fokusuar relativisht pak në fuqizimin e kapaciteteve tona të diplomacisë ekonomike. Duhet të bëhet shumë më tepër në këtë aspekt. Kjo nuk duhet të mbetet vetëm në nivel të deklarimit ose një zotim deklarativ, por duhet të shohim angazhim shumë më serioz të institucioneve të vendit. Në këtë aspekt fuqizimi i diplomacisë ekonomike pashmangshëm që do të ndihmonte edhe në fuqizimin e subjektivizmit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, pse jo meqenëse përmes raporteve ekonomike tregtare shpeshherë ndërtohen dhe raportet e bashkëpunimit me shtete të cilat nuk e kanë njohur ekzistencën e Kosovës siç është rasti i Greqisë", ka thënë Zeka.

Kreu i OEAK-ut, Zeka, ka bërë me dije se Kosova ka resurse njerëzore dhe mjete buxhetore të mjaftueshme për rritjen e aktivitetit të Kosovës në fushën e diplomacisë ekonomike. Ai ka shtuar se është koha e fundit që të bëhet diçka e tillë nga kjo qeveri. "Kjo nuk duhet të mbetet vetëm në nivel deklarativ. Besoj që kemi kapacitete njerëzore, kapacitete buxhetore dhe financiare për jetësimin ose rritjen e aktivizimit të Kosovës në




fushën e diplomacisë ekonomike. Duhet të emërohen atasheetë ekonomike nëpër qytete të shteteve në të cilat ka prani më të madhe ose aktivitet më të madh ekonomik në nivel global. T'i shmangim ndoshta qendrat e shteteve qofshin ato të Evropës perëndimore apo edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, apo shteteve të Azisë, por të fokusohemi më tepër në qendrat në të cilat ka aktivitet më

të madh industrial dhe ekonomik. Është momenti i fundit që të bëhet diçka e tillë në këtë aspekt", ka theksuar ai. Kryetari i bordit të Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), Skënder Krasniqi, ka thënë se Kosova është i vetmi shtet që nuk ka atashe ekonomike. Krasniqi ka thënë se vendi duhet sa më parë të ketë atashe ekonomike nëpër botë për paraqitjen e ofertës të të bërit biznes.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë se një diplomaci ekonomike e mirëfilltë do të lehtësonte shumë procese për vendin, edhe në raportet politike, përfshirë njohjen e Kosovës dhe liberalizmin e vizave. Roli i atasheve ekonomike është i rëndësishëm në diplomacinë ekonomike për promovimin e vlerave dhe kapaciteteve në të gjithë sektorët ekonomikë.

Të rinjtë duhet të orientohen drejt nevojave të tregut



GJILAN, 18 SHKURT (ER) - Njoftimi mbi aktivitetet dhe punën e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), diskutimi lidhur me mundësitë e bashkëpunimit, krijimi i linjave të komunikimit për delegimin e problemeve me të cilat ballafaqohen bizneset e komunës së Gjilanit, e ofertat e kësaj komune për bizneset e interesuara që të

investojnë në këtë rajon, ishin qëllimi i takimit të përfaqësuesve të Odës së Afarizmit të Kosovës me kryetarin e komunës së Gjilanit, Alban Hyseni.

Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e Odës së Afarizmit e uruan Hysenin për pozitën e kryetarit të komunës duke u shprehur të hapur për të ofruar bashkëpunim profesional

në çështjet me interes reciprok. OAK-u në këtë takim shpallti prioritetet e saj, disa nga aktivitetet, bizneset që përfaqëson e çështjet për të cilat është duke lobuar aktualisht.

Ndër të tjera, u theksua edhe rëndësia e komunikimit dhe bashkëpunimit më të madh mes sektorit privat dhe atij publik, duke

përfshirë institucionet qendrore e ato lokale, në mënyrë që vendimet të mos merren ad-hoc, por të koordinuara paraprakisht. Hyseni, duke falënderuar përfaqësuesit e OAK-së për takimin dhe çështjet e ngritura, u shpreh i hapur për bashkëpunim reciprok. Hyseni shpallti disa nga projektet aktuale të komunës së Gjilanit me

qëllim të ofrimit të përkrahjes dhe krijimit e kushteve më të mira për të bërë biznes në këtë komunë.

Gjithashtu, kryetari theksoi rëndësinë e orientimit të të rinjve drejt nevojave të tregut, me qëllim të arsimit dhe aftësimin profesional, dhe rëndësinë e ndërlidhjes së bizneseve dhe të rinjve me tregun e punës.

Nuk mund të ndryshohet e as rishkruhet historia e çlirimit dhe pavarësisë së Kosovës



Shkruan: Ismail SYLA

(Një qasje Gëteane përmes Faustit)

Disa qarqe ende të gjalla të frymës jugosllave në Kosovë arrestimin e liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës po e konsiderojnë si moment të fillimit të një narracioni të ri që konteston kontributin vendimtar dhe historik të tyre për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës.

Ata duan ta shembin çdo shtyllë të kësaj ngrehine të pathyeshme. U përpoçën me libra që ta kontestojnë një pas një çdo përbërës të UÇK-së. Së pari që ajo nuk ka qenë Ushtri. Që nuk ka qenë Çlirimtare. Që nuk ka qenë e Kosovës (Veton Surroi)

Këtyre ditëve dolën zëra (Albin Kurti) se Kosova është shpallur e pavarur më 10 shkurt 2007 kur u shënuan dy viktima në protestat e VV. Dhe aq më

tepër që më 17 shkurt 2008 Kosova u shpall shtet i pavarur dhe demokratik nga njeriu ose personi jo i duhur (S. Z.)

Jo. Historia nuk shembet dhe as nuk përmbysset lehtë. As përmes pasioneve personale as përmes kalendarit të zgjedhjeve parlamentare. Ajo ka përjetësinë faktike, historike, të pandryshueshme, të përjetshme dhe faustiane.

Çlirimi i Kosovës në esencë e ka çelësin përtej zënafillës bibleke, brenda qasjes faustiane sipas gjeniut gjerman të letrave Johan Wolfgang von Goethe. Fausti e fitoi betejën me djallin, me Mefistofelin sepse moto të qëllimit të tij jetësor e bëri jo fjalën, jo forcën por VEPRIMIN. Në fillim ishte veprimi.

Fausti arriti që me idealin e veprimit në të mirë të njerëzimit të rris sipërfaqen e tokës, steresë në bregdet, duke ia marrë hapësirën detit. Kur mbretëria fiktive gjermane e kohës ishte para falimentimit dhe në anëkandin metaforik mund të shitej ose t'i dhurohej kishës, në atë pazar tragjik nuk mund të futej toka e re e Faustit.

Kjo tokë e re që fitoi aq shumë imunitet dhe moskontestim pronësor ishte rezultat i punës dhe mundit. Ishte thelbi i motos së shpirtit faustian se nderin dhe lirinë e meriton vetëm ai që për to (nderin, lirinë, vër. ime) shkon në luftë (që t'i arrijë, t'i fitojë) çdo ditë.

Fausti i palodhur nga veprimi dhe puna, vdiq në moshën 100 vjeçare në këmbë. Mefistofeli, e

keqja, djalli, e humbi bastin dhe betejën me Faustin, sepse Fausti krijoi hapësirë të re, krijoi realitet të ri. I mori detit tokë, ose në ujën e detit ngriti tokë të re. Për këtë arsye Zoti nuk ia la në dorë shpirtin e Faustit djallit Mefistofel, sepse mbi botën e kënaqësive ngadhënjëu bota e idealeve krijuese.

Kosova e robëruar ishte tokë e humbur në det (nën Serbi). Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e para dhe e vetmja organizatë politiko ushtarake serioze e Kosovës, arrit që ta çlirojë Kosovën nga pushtimi serb. Ky çlirim ka aktorë: liderët e UÇK-së. Liria ka emër: Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Në historinë e përjetshme të kombit tonë liderët e UÇK-së që sot mbahen në burgun e Hagës i përkasin botës

faustiane të Goethes. Emrat e tyre lidhen me veprimin konkret të çlirimit të Kosovës. Kjo memorie është më e fuqishme dhe më e qëndrueshme se çdo pergamenë, çdo mermer dhe çdo granit.

Aktet madhore që ndodhin në historinë e kombit nuk janë kopshte personale ku për çdo vjet mbillen perime.

Historia Kosova nuk mund të rikthehet prapa dhe të ndërrohen aktorët.

Ka vetëm një Epope të Prekazit të 5 marsit 1998. Ka vetëm një Adem Jashar, një Hamëz Jashar...

Ka vetëm një 17 shkurt 2008 dhe vetëm një Hashim Thaç. Prishtinë, 16 shkurt 2022, në vigjilje të 14 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë.

EURO GLASS
SAINT-DONAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Drita dhe Llapi sot luajnë për rezultat pozitiv

Një nga dy derbit e javës së 20 në Superligën e futbollit do të zhvillohet sot (e shtunë) në Gjilan në mes të Dritës dhe Llapit. Të dyja skuadrat në konferencat për medie, një ditë para ndeshjes, kanë paralajmëruar se do të luajnë për të nxjerrë rezultat pozitiv

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 SHKURT - Forma e mirë e Llapit në dhjetë ndeshjet e fundit nuk e ka shqetësuar aspak trajnerin e Dritës, Ardian Nuhiun, i cili fillimisht e ka lavdëruar skuadrën llapjane, më pas ka bërë me dije se gjilanasit synojnë ta marrin maksimumin e pikëve. "Na pret një ndeshje realisht shumë e fortë, me një kundërshtar të vështirë. Nëse shohim ecurinë e tyre në dhjetë ndeshjet e fundit, janë ndër më të mirët. Jemi munduar t'i analizojmë, kanë skuadër të mirë dhe rezultatet e tyre të deritanishme nuk janë të rastësishme. Skuadra jonë është gati dhe më gëzon fakti që të gjithë futbollistët janë mirë me shëndet dhe kemi marrë të gjitha masat se si ta gjejmë rrugën që ta kalojmë këtë pengesë, realisht mjaft të vështirë. Kemi futbollistë kualitativë për të cilët shpresoj që të shprehin në terren dhe të tregojnë e të marrin më të mirën. Të gjithë janë të gatshëm për të performuar në një ndeshje të madhe, e cila mendoj se është e tillë", ka thënë trajneri Nuhiu.

Për këtë ndeshje foli edhe futbollisti Ilir Blakçori, i cili, po ashtu, pret rezultat pozitiv. Edhe mbrojtësi në fjalë e ka lavdëruar skuadrën e Llapit, duke thënë se ka një ekip shumë cilësor. "Do të jetë një ndeshje e vështirë, pasi Llapi ka një ekip cilësor, me lojtarë të dëshmuar në Superligë. Do të mundohemi t'i kryejmë detyrat ashtu si edhe kemi punuar gjatë tërë javës. Jemi të përgatitur dhe të freskët edhe nga faza përgatitore, e cila na ka ndihmuar shumë. Kemi analizuar kundërshtarin dhe do të mundohemi t'i shfrytëzojmë ato pika më të dobëta që mund të na krijohet hapësira gjatë lojës. Shpresoj ta



japim maksimumin dhe të marrim rezultat pozitiv në një ndeshje të madhe e derbi si kjo", ka deklaruar Blakçori.

Ndeshja në mes të Dritës dhe Llapit zhvillohet në orën 13:00 në stadiumin "Selami Osmani - BEZI". Krahas kësaj ndeshjeje sot (e shtunë) zhvillohet edhe përballja në mes të Ulpianës dhe Malishevës. Të dielën zhvillohen tri ndeshje të tjera, kurse kryesorja zhvillohet në stadiumin "Zahir Pajaziti" mes Prishtinës dhe Ballkanit. Trajneri i skuadrës së Llapit, Tahir Batatina, ka thënë se Llapi është i motivuar për të arritur rezultat pozitiv. "Ndeshja ndaj Dritës ka një përshtypje të veçantë. Djelmohat janë të motivuar maksimalisht dhe do ta japim maksimumin. Kemi arritur të marrim fitore në ndeshjen për Kupë ndaj Ferizajt dhe në kampionat ndaj

Ulpianës. Nuk kemi presion. Do të shohim si do të shkoj ndeshja, por ne jemi të motivuar për të dhënë gjithçka nga vetja", ka thënë Batatina. "Ndeshje shumë e rëndësishme për ne. E dimë që Drita ka një skuadër cilësore e cila ka lojtarë cilësorë brenda grupit, por edhe ne kemi një skuadër shumë cilësore ku kemi kualitet dhe cilësi brenda ekipit", ka shtuar Batatina.

SUPERLIGA - Java e 20

Të shtunën takohen:
13:00 Drita - Llapi
13:00 Ulpiana - Malisheva

Të dielën takohen:
13:00 Feronikeli - Gjilani
13:00 Dukagjini - Drenica
13:30 Prishtina - Ballkani

SHKURT

Konfirmohet miqësorja Kosova - Burkina Faso

Në kuadër të ndeshjeve miqësore të muajit mars, Federata e Futbollit e Kosovës ka aranzhuar ndeshje miqësore ndaj Burkina Fasos. Takimi me Burkina Fason do të zhvillohet më 24 mars në Prishtinë. Kombëtarja e Burkina Fasos pak ditë më parë arriti deri në gjysmëfinale të Kupës së Kombeve të Afrikës dhe aktualisht renditet në vendin e 56 në ranglistën e FIFA-s, prandaj çmohet si një kundërshtar mjaft e fortë për Kosovën. "Dardanët" kanë luajtur kundër Burkina Fasos miqësore edhe në mars të vitit 2018. Atë takim Kosova e kishte fituar me rezultat 2-0. Kosova do të zhvillojë edhe një ndeshje tjetër miqësore me Zvicrën që zhvillohet në Cyrih më 29 mars.

Trajneri i Norwichit: Jam shumë i kënaqur me Rashicën

Trajneri i Norwich Cityt, Dean Smith, është shumë i kënaqur me sulmuesin e Kosovës, Milot Rashicën. 25-vjeçari nga Vushtrria ka shënuar vetëm një gol në FA Cup, por Smithi është optimist se shumë shpejt ai do të shënojë edhe në ligë. "Miloti është ai me të cilin jam shumë i kënaqur. Ai ka vetëm një gol në FA Cup, por ka bërë disa asistime dhe nuk do të kalojë shumë kohë para se të shënojë në ligë", u shpreh trajneri i Norwichit.

Ndeshja Prishtina - Ballkani zhvillohet në stadiumin 'Zahir Pajaziti'

Ndeshja e xhiros së 20 në Superligën e Kosovës në futboll ndërmjet FC Prishtina dhe FC Ballkani do të zhvillohet të dielën, në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë. Ndeshja Prishtinë - Ballkan do të zhvillohet në orën 13:30 dhe do të transmetohet në platformën "Art Motion" si dhe në "Klan Kosova". "Prishtina as duelin ndaj Ballkanit, sikurse atë ndaj Drenicës në Kupën e Kosovës, nuk do ta zhvillojë në fletën e saj, në stadiumin 'Fadil Vokrri' për shkak të punimeve që janë duke u kryer në tapetin e gjelbër", thuhet në njoftimin e klubit kryeqytetas. Prishtina para kësaj ndeshjeje renditet në pozitën e pestë me 24 pikë të mbledhura, derisa Ballkani ndodhet në vendin e dytë me 36 pikë.

Ndeshje interesante në Superligën e hendbollit

PRISHTINË, 18 SHKURT - Në fundjavë zhvillohet xhiroja e 16 e Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Të shtunën janë tri ndeshje, ndërsa në dy prej tyre pritet rivalitetet dhe hendboll i mirë. Trepça e Rahoveci takohen nga ora 18:00 në palestrën "Minatori" në Mitrovicë. Vendasit llogaritin në dy pikë, por edhe "vreshtarët" udhëtojnë me pretendime. Për Rahovecin është ndeshja e parë

në pranverë, ndërsa Trepça është e motivuar pas barazimit në kryeqytet me Prishtinën. Trepça është e dyta me 25 pikë, ndërsa Rahoveci mban vendin e katërt me 18 pikë, kurse e ka një ndeshje më pak të luajtur. Llapi - Prishtina është ndeshje tjetër e së shtunës, që fillon në orën 19:00. Prishtina është favorite, por Llapi do të synojë pikë. Prishtina është e treta me 25 pikë, ndërsa Llapi mban vendin e tetë me 10 pikë. Edhe

Drenica - Deçani luhet të shtunën prej orës 19:00. Deçani llogaritet favorit. Të dielën është ndeshja në mes të Kastriotit dhe Vëllaznimit që, po ashtu, do të ofrojë rivalitet. Kjo ndeshje fillon prej orës 18:00. Kastrioti është i pesti me 14 pikë, ndërsa Vëllaznimi i gjashti me 12 pikë. Pikët janë të rëndësishme për të dyja skuadrat. Besa Famgas është e lirë këtë xhiro pas largimit të Zhegrës nga garat.



Besim Aliti emërohet anëtar i Komisionit të Programit të Sporteve të Lojërave Mesdhetare

PRISHTINË, 18 SHKURT - Sekretari i përgjithshëm i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Aliti, është emëruar anëtar i Komisionit të Programit të Sporteve të Lojërave Mesdhetare. Vendimin e ka marrë

presidenti i Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare (ICMG), Davide Tizzano. "Kam kënaqësinë t'ju informoj se me vendim të presidentit të ICMG-së, Davide Tizzano, dhe me pëlqimin e Komitetit

Ekzekutiv të ICMG-së, emëroheni anëtar i Komisionit të Programit të Sporteve të LM-s, kryetar i së cilës është Mohamed Zribi", thuhet në njoftimin e sekretarit të përgjithshëm të ICMG-së, Iakovos Filippousis.

Lojërat e ardhshme Mesdhetare mbahen në Oran të Algjerisë nga 25 qershori deri më 5 korrik. Sekretari i përgjithshëm, Aliti, është anëtar edhe i Komisionit për EYOF të Komitetit Olimpik të Evropës.



Fabregas: Messi u kritikua në vitin e parë të Luis Enriques, por më pas Barcelona fitoi tripletën

MONACO, 18 SHKURT - Cesc Fabregas është një nga njerëzit që e njeh më mirë Lionel Messin, pasi u ngjiti në radhët e të rinjve të Barcelonës në të njëjtin grupmoshë dhe spanjollit ka dalë në mbrojtje të mikut të tij të ngushtë mes kritikave për argjentinasi. Mesfushori i Monacos foli për fitoren 1-0 të Paris Saint-Germainit në raundin e 1/16 të Ligës së Kampionëve ndaj Real Madridit dhe mendon se Los Blancos ka marrë qasjen e gabuar. "Real Madridi u tërhoq që në fillim dhe kjo nuk është kurrë një shenjë e mirë", ka thënë fillimisht Fabregas për "Mundo Deportivo". "Ata, gjithashtu, nuk dinin si ta mbanin topin për një kohë të gjatë, pavarësisht se kishin lojtarë si Casemiro, Kroos dhe Modric, të cilët kanë fituar radhazi tri Liga të Kampionëve. Benzema dhe Mendy nuk ishin 100 për qind të aftë dhe ata e paguanin për këtë. Fizikisht, PSG ishte përpara tij kundër Real Madridit, por



Fabregas nuk pajtohet me këto vlerësime", ka shtuar Fabregas. "Kam lexuar gjëra nga njerëz që nuk duhet ta kenë parë atë të luajë kundër Real Madridit. Ai luajti një lojë të mirë. E futi Mbappen në portë në pjesën e parë me një pasim që asnjë nga 21 lojtarët e tjerë nuk mund ta bënte. Ai humbi një penallti. Po çfarë? Të gjykosësh për këtë më duket qesharake. Më kujtohet viti i parë i Luis Enriques si trajner i

Barcelonës në të cilin Messi u kritikua shumë. Kishte një krizë rreth kësaj. Pastaj Barcelona fitoi tripletën. Tani diçka e ngjashme mund të ndodhë. Unë e kuptoj që historitë duhet të shiten, por ne po flasim për një lojtar që mund t'ju bëjë t'i hani fjalët tuaja për një sekondë. Me Messin duhet të jesh gjithmonë i kujdesshëm, për çdo rast. Ka shumë të tjera për të ardhur", ka deklaruar mesfushori spanjoll.

SHKURT

Hamiltoni thyen heshtjen: Vendosa të kthehem të sulmoj

Lewis Hamiltoni ka thyer heshtjen dhe është kthyer të flasë para medieve pas garës që i hoqi nga duart titullin kampion të radhës, duke ia dhuruar Max Verstappenit. Piloti britanik ishte i pranishëm në paraqitjen e makinës së re Mercedes për sezonin 2022 përkrah drejtorit sportiv Toto Wolff, si dhe shokut të ri të skuadrës, George Russell. "Ishte një periudhë e vështirë për mua dhe një periudhë kur unë kisha nevojë të bëja një hap prapa dhe të fokusohesha tek e tashmja. Kisha familjen rrotull dhe po krioja kujtime të bukura me ta. Derisa mbërrita në një pikë ku vendosa që do të sulmoja përsëri duke u kthyer në sezonin e ri dhe duke punuar përkrah Toto dhe Xhorxh. Unë nuk e kam thënë asnjëherë që do të ndalesha. Unë e dashuroj atë që bëj dhe është një privilegj i madh të punosh me këtë grup të madh njerëzish teksa ndien se je pjesë e një familje. Nuk ka asgjë si kjo", ka thënë Hamiltoni.

Newcastle, gati ta bëjë ofertë për Pogban

Futbollisti francez Paul Pogba mund të largohet nga Manchester Unitedi gjatë verës që vjen, por jo edhe nga Anglia. Mediumi "Fichajes" raporton se mesfushori është bërë objektiv i Newcastle Unitedit. Klubi anglez, i cili ra në duart e miliarderëve arabë, është i gatshëm t'ia ofrojë një kontratë marramendëse Pogbas. Kampioni i botës me Francën është duke kaluar muajt e fundit të kontratës me "Djajtë e Kuq" dhe e ka të drejtën absolute për ta zgjedhur klubin e ri. Në garë për 28-vjeçarin që një kohë janë edhe Paris Saint-Germaini, Real Madridi dhe Juventus.

Carragheri, Unitedit: Shiteni Ronaldon

Ish-mbrojtësi i Liverpoolit, Jamie Carragher, e ka këshilluar skuadrën e Manchester Unitedit që të heqë dorë nga Cristiano Ronaldo për të shmangur kështu gabime më të mëdha. "Kontributi i pavlefshëm i Ronaldos te Manchester Unitedi, në fitoren ndaj Brightonit, ishte një tjetër rast që na kujtoi apetitin e tij të pashembullt për gola. Por nuk ndryshon realitetin: Unitedi bëri gabim me rinëshkrimin me Ronaldon gjatë verës së kaluar. Do të jetë një gabim më i madh nëse e mbajnë sezonin tjetër", ka thënë Carragher.

Anelotti rezikon shkarkimin

Real Madridi udhëheq kampionatin në Spanjë, por kjo duket e pamjaftueshme për të kënaqur një president si Perez. Carlo Ancelotti dhe madrilenët mund ta ndërpresin marrëdhënien e tyre përpara kohe. Shkak mund të bëhet ajo disfatë zhgënjyese në "Parc de Princes", me rezultatin 1-0. Sipas medieve spanjolle, nëse madrilenët nuk ia dalin të kualifikohen kundër Paris Saint Germainit, tekniku italian nuk do të jetë më në krye të ekipit, madje presidenti Florentino Perez duket se e ka gati zëvendësuesin e tij dhe ai quhet Mauricio Pochettino.

Miami triumfon pas kohës shtesë, humbasin Brooklyn dhe Bucks

PHOENIX, 17 SHKURT - Fitorja e shtatë radhazi për Phoenixin, që mposhti me rezultat 124-121 Houstonin dhe konsolidon pozitën në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit në NBA. Ndeshje me rivalitet, vendosur në fund, me Bookerin autor i 24 pikëve



Për Jazzin u dallua Mitchell me 37 pikë, por që s'mjaftuan. Humbet edhe ekipi i Golden States, që u mund në sekondën e fundit me rezultat 117-116 nga Denveri. Nikola Jokiq realizoi 35 pikë e 17 rebounde. Fiton edhe Brooklyn, që mundi 111-106 New Yorkun në derbi, ndeshje ku u dalluan Thomasi me 21 pikë e Curry me 20. Në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes ngjitet ekipi i Chicagos, që mundi me rezultat 125-118 Sacramento, takim ku u dalluan DeRozani me 38 pikë e Whyte me 31 pikë.

e Ayton 23. Ndërkohë që, 41 pikë erdhën nga lojtarët e stollit, vendimtarë në këtë sfidë. Rikthehet te fitorja skuadra e lakersave, që mundi me rezultat 106-101 nga Utah Jazz, sfidë ku u dallua LeBron Jamesi me 33 pikë.

REZULTATET

Charlotte - Miami	107-111
Brooklyn - Washington	103-117
New Orleans - Dallas	118-125
Milwaukee - Philadelphia	120-123
Clippers - Houston	142-111

PSG-ja, ofertë të çmëndur për ta mbajtur Mbappen

PSG-ja po bën gjithçka për ta mbajtur Kylian Mbappen dhe konfirmimi vjen nga "Mundo Deportivo". Gazeta spanjolle raporton për rritjen e ofertës së fundit, të paraqitur nga klubi parisien të përfaqësuesit e 23-vjeçarit. Kjo ofertë është

strukturuar në tetë pika themelore, të cilat shkojnë përtej anës thjesht ekonomike. Ndërkohë, kontrata do të zgjatej vetëm me një vit, me një pagë javore prej një milion eurosh, për një total prej gati 50 milionë

eurosh në vit. Kjo do ta bënte atë futbollistin më të paguar në botë. Për më tepër, komisionet dhe shpërblimet e bazuara në performancë mund të çojnë në dyfishimin e pagës së tij. Mbappe do të kishte gjithashtu në

dispozicion kontrata ekskluzive reklamimi dhe marketingu me kompani të mëdha, të lidhura me ekosistemin e biznesit të "Qatar Sports Investments". Gjithashtu, edhe një komision milionerësh, që asnjë klub

tjetër nuk mund ta arrijë për ta garantuar nënën dhe agjentin e tij. Projekti i PSG-së do të fokusohet tek ai, Mbappe do të bëhej protagonist absolut i strategjisë globale që Katari përgatit për Botërorin e këtij fundviti.

PROTESTË!

*Proteston, refuzon, mallkon, pena e shkrimtarit:
Kur burgosen çlirimtarët, burgoset edhe
populli!
Kur burgoset UÇK-ja, burgoset edhe liria!*




“Hero në luftë, Hero në paqe” – 1



“Drenica para gjyqit” – 2



“UÇK-ja para gjyqit” – 3



“Na e ban hallall, Kosove” – 4



*“Edhe malet janë Kosova para gjyqit,
UÇK - 5*



*Murtaja e Kuqe-7
dramë, 6*

(Këta janë 7 libra publicistikë, të botuar nga Riza Greiçevci për Gjykatën Speciale të Hagës, ku po gjykohen: UÇK-ja, çlirimtarët, Drenica, liria, dëshmorët, pushka e Adem Jasharit, Kosova...!)



Shoqëria Humanitare e Barmëve e Kosovës "Mëta Teresa"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarisno Dobrotvorno Udruženje Kosovo "Majka Teresa"
10000 Prishtinë, Rr. ULPIANA U1/1 p.n. Tel:00381 38 542 864, Fax:542 869,
Web site: www.khcs.org e-mail:nterezaj@yahoo.com

CONTRACT AWARD NOTICE SERVICES

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 18/02/2022

Procurement No	Training	001	2022	221
----------------	----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code:10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone:044-128-277	
Email:zefshala@hotmail.com	Fax:038-542-865	
Internet address (if applicable):	www.matherteresasociety.org	

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:
Training on Entrepreneurship and self-employment for 560 participants -New beneficiaries
(Returnees and people at risk of illegal emigration)

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance
(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

<input type="checkbox"/> Services
Main place of performance All Kosovo according to the Request of Contracting Authorities

II.1.4) Short description of the object of the contract
Training on Entrepreneurship and self-employment for 560 participants -New beneficiaries
(Returnees and people at risk of illegal emigration)

II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)

Standard Form "Contract Award Notice"

1

93.000.000.-8

II.1.6) Division into lots NO

II.1.7) Contract value: 116,200.00

SECTION III: PROCEDURE

III.1) TYPE OF PROCEDURE

Open

III.2) AWARD CRITERIA

Lowest price

III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)

IV.1) Date of contract award	18/02/2022	
IV.2) Intended date of contract signing	01/03/2022	
IV.3) Number of received tenders	5	
IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded		
Official name:	D&D Business Support Centre L.L.C	
Postal address:	10000 Prishtinë	
Town:Prishtinë	Postal code:10000	Country: Kosovo
URL (if applicable):		
Contact point(s): Drilona Selmani	Email: info@dd-bsc.com	
Telephone: +38338748701	Fax: +38338748701	

IV.5) Information on value of contract

Total final value of contract 116,200.00 Euro
Responsive tender with lowest price: 116,200.00 Euro
Responsive tender with highest price:156,800.00 Euro

IV.6) The contract is likely to be subcontracted No

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092 ,at the address specified in Section I of this Contract award notice.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania "OSKOS" L.L.C. me seli në Prizren ka marrë vendim të shuaj biznesin me numër të regjistrimit: **811385922** dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30-ditorë nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavještamo sve klijente da Tvrtka "OSKOS" D.O.O. u Prizren doneo odluku da ugasi biznis po br. registra: **811385922** I ujedno imenovao Likfidatora o sprovođenju postuaka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze I potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that the Company "OSKOS" L.L.C. based in Prizren has taken the decision to terminate the business with registration number: **811385922** and has appointed the liquidator to conduct the Liquidation procedure. All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Zejniha Maloku shpalle të pavlefshme dëftesën e klasës së 9-të të shkollës fillore "Andon Zako Çajupi".
- ▶ Arben Durmishaj shpall të pavlefshme dëftesën dhe diplomën e SHMLM "Dr. Xheladin Deda".
- ▶ Vildane Hoxha shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e "Dr. Xheladin Deda".
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

